

Njoftim për përqendrim me të cilin MTEL SHPKNJP Shkupi fiton kontrollin mbi Lajkamobajl SHPKNJP Shkup

(lënda nr. 08-91/2024)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 30.05.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në rrugën Maksim Gorki 11/1 kati 3, Shkup në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të fitoj kontrollin individual mbi Shoqërinë për telekomunikacion Lajkamobajl SHPKNJP Shkup, me seli në bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 15, 1000 Shkup, në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup është operator i notifikuar i telekomunikacionit nga Agjencia për Komunikime Elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtarinë e telekomunikacionit me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe ritransmetimin e programeve dhe shërbimeve televizive.

Shoqëria për telekomunikacion Lajkamobajl SHPKNJP Shkup është operator i notifikuar i telekomunikacionit nga Agjencia për Komunikime Elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila punon në treg për ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik celular.

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shoqëria e telekomunikacionit Lajkamobajl SHPKNJP Shkup nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si treg përkatës për vlerësimin e përqendrimit në fjalë mund të përcaktohet një treg me pakicë për ofrimin e shërbimeve të telefonisë celulare në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

10.06. 2024

Shkup